

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 02 —————>

SHTATOR 2021



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

Masa 1 → Mbështetja e Punësimit

Për buletinin


Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është publikim i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, përmes të cilët do të ofrohet informimi i detajuar rreth Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për qytetarët e Republikës së Kosovës. Masat të cilat i përfshin kjo pako, kanë për qëllim lehtësimin e problemeve dhe dëmeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është i realizuar në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

Edicioni i dytë i buletinit ka të përfshirë informata rreth masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e quajtur Mbështetja e Punësimit. Gjithsej kjo masë ka të alokuara 50 milionë Euro, të cilat janë të ndara në shtatë nënmasa. Përmes këtij buletini, synohet të informohen qytetarët më në detaje, e në veçanti qytetarët përfitues të kësaj mase.

→ Nënmasat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike

Si në gjithë botën, edhe në Republikën e Kosovës pandemia COVID-19 shkaktoi dëme për të cilat nevojitet kohë e gjatë që të riparohen. Qytetarët përpos rrezikimit të shëndetit, rrezikuan edhe vendet e punës, e një pjesë e tyre edhe e humbën atë. Gjithë këto vështirësi dhe probleme që u shkaktuan si pasojë e pandemisë, po trajtohen tashmë dhe do të vazhdojnë të trajtohen edhe në të ardhmen.

Sipas Agjensisë së Statistikave të Kosovës¹, 28.4% e popullësisë të cilët janë në moshë pune ishin të punësuar gjatë vitit 2020.² Në vitet paraprake, respektivisht 2018 dhe 2019, shkalla e punësimit ishte 28.8% dhe 30.1%. Shkalla e papunësisë për vitin 2020 do të ishte edhe më e lartë, nëse nuk do të regjistroheshin si të punësuar shumë qytetarë, të cilët kanë punuar në ekonominë joformale, por për shkak të përfitimit nga masat e pakos së parë të ndihmave nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ata u regjistruan si të punësuar.



1 Agjencia e Statistikave të Kosovës, ASK, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/>

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës, ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/media/6125/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2020.pdf>

Si një sektor shumë i prekur nga pandemia COVID-19, masa e parë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike i dedikohet qytetarëve për mbështetje të punësimit. Masa e parë e quajtur Mbështetja e Punësimit, është prioriteti i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të saj janë alokuar **50 milionë Euro**.³ Gjithsej kjo masë përfshinë shtatë pika apo nënmasa, të cilat sipas kategorisë do t'i alokojnë edhe shumat e parave për qytetarët e dëmtuar. Shtatë nënmasat e masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë:

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë



2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar



3. Mbështetja e punësimit të grave



4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë



5. Trajnimi dhe punësimi në TI



6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta



7. Skema e granteve për zanatet



³ Ministria e Financave, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 1, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/7EB4F774-43C5-4471-9942-09197BC03E4E.pdf>

NËNMASA 1.1.

RIKTHIMI NË PUNË I ATYRE QË KANË HUMBUR VENDIN E PUNËS GJATË PANDEMISË

Për nënmasën e parë të masës së parë janë ndarë 10 milionë Euro. Të gjithë qytetarët, të cilët humbën vendin e punës gjatë periudhës mars 2020 – prill 2021 si pasojë e pandemisë COVID-19, do të mund të përfitojnë nga ndihmat e kësaj nënmasë. Gjithashtu është përfshirë edhe ndihma për çdo të ri-punësuar, ku do të subvencionohet paga për 3 muaj në vlerë prej 170 euro në muaj. Kjo nënmasë tashmë veq se ka filluar implementimin dhe verifikimi nëse një punëkërkuar kualifikohet, mund të bëhet përmes webfaqes së ATK-së në linkun: <https://apps.atk-ks.org/Subvencionim>. Kushti për kualifikim është që punëkërkuar të figurojë i punësuar në periudhën dhjetor 2019 - shkurt 2020, dhe i papunësuar në periudhën prill 2021 – qershor 2021.

NËNMASA 1.2.

MBËSHTETJA PËR TË PUNËSUARIT E FORMALIZUAR

Mbështetja për të punësuarit e formalizuar apo nënmasa e dytë e masës së parë, mbanë në vete shumën prej **10 milionë Euro**. Këto mjete janë të ndara apo të dedikuara për qytetarët të cilët janë të punësuar të ri, dhe që nuk kanë qenë të punësuar në tre muajt e fundit, e të cilët deklarohen në ATK prej periudhës tatimore korrik 2021.


Kushti për përfitimin nga kjo nënmasë është që i punësuarit **TË MOS FIGUROJË** si i regjistruar në periudhën tatimore qershor 2021 e më herët.

Kësaj kategorie përfituese do t'iu paguhen kontributet pensionale në vlerë prej 10% të pagës bruto deri në 12 muaj me radhë, pra deri në qershor 2022.

NËNMASA 1.3. → MBËSHTETJA E PUNËSIMIT TË GRAVE

Mbështetja për të punësuarit e formalizuar apo nënmasa e dytë e masës së parë, mbanë në vete shumën prej **10 milionë Euro**. Këto mjete janë të ndara apo të dedikuara për qytetarët të cilët janë të punësuar të ri, dhe që nuk kanë qenë të punësuar në tre muajt e fundit, e të cilët deklarohen në ATK prej periudhës tatimore korrik 2021.⁴

Shkalla e punësimit për vitin 2020




Një përqindje e tillë është mjaft shqetësuese, duke e ditur se gjysma e popullësisë është e përbërë nga kjo gjini, dhe si rrjedhojë, është parë e arsyeshme që në Pakon e Ringjalljes Ekonomike të përfshihen edhe ndihmat të cilat janë të dedikuara për grat. Gjithsej kjo nënmasë ka të alokuara **5 milionë Euro**.

Me këtë nënmasë parashihet subvencionimi i pagës për 50%, **MAKSIMUM 170 EURO**, për tre muajt e parë për të gjitha gratë që punësohen nga periudha tatimore korrik 2021.

⁴ Agjensia e Statistikave të Kosovës, ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/media/6125/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2020.pdf>

NËNMASA 1.4. → SKEMA E PUNËSIMIT TË GARANTUAR PËR TË RINJTË

Nënmasa e katërt e quajtur Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë, është pjesë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike me shumën e dedikuar prej **10 milionë Euro**. Në Republikën e Kosovës, edhe para fillimit të pandemisë, të rinjtë e moshave 18-24 vjeç kanë hasur në vështirësi për të qenë të punësuar, dhe pandemia COVID-19 vetëm sa e ka vështirësuar këtë proces. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, niveli i papunësisë për grupmoshat 15-24 vjeç është 49.4%. Një shifër e tillë është mjaft alarmante, andaj përmes kësaj pike, do të mundësohet apo të garantohet punësimi për këto grupmosha, ku secilit të ri do t'i garantohet puna e parë, e subvencionuar nga shteti në nivelin e pagës minimale.



NËNMASA 1.5. TRAJNIMI DHE PUNËSIMI NË TI

Trajnimi dhe punësimi në TI (Teknologji të Informacionit), është nënmasa e pestë e masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Si një fushë me perspektivë të madhe, dhe me një të ardhme e cila do të varet shumë nga kjo degë, është integruar nënmasa e tillë, e cila do të ndihmojë qytetarët që të akomodohen në vende pune. Kjo do të bëhet përmes kuponëve me anë të së cilëve do të ndiqen kurse për TI, apo trajnime në praktikë. Ndërsa për qytetarët të cilët përfundojnë kurset e ofruara, do të iu ofrohet ndihma për punësim për tre muajt e parë. Në total kjo nënmasa ka të ndara **5 milionë Euro**.



NËNMASA 1.6. MBËSHËTETJA E PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Për të kontribuar në krijimin e një shoqërie të barabartë, dhe në të njëjtën kohë avansimin e personave me aftësi të veçanta, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë shumën prej **5 milionë Euro**. Përmes kësaj nënmase, do të mbështeten të gjithë personat që i përkasin kësaj kategorie. Mbështetja do të bëhet përmes mbulimit të 50% të pagës (deri në 150 Euro në muaj), për gjashtë muajt e parë.



NËNMASA 1.7. → SKEMA E GRANTEVE PËR ZANATET

Nënmasa e fundit e masës së parë, e quajtur Skema e granteve për zanatet, ka të dedikuara **5 milionë Euro** për këtë kategori punëtorë. Ndihma do të alokohet përmes granteve tek ata persona të cilët do të çertifikohen me aftësi profesionale në zanate. Shuma e granteve të parashikuara për këtë kategori është deri në 3,000 Euro. Kjo skemë synon zvogëlimin e papunësisë, si dhe shtyerjen drejt aftësimimit në zanate. Këto grante do të mbulojnë blerjen e pajisjeve dhe formimin e biznesit.





“Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.”